



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1147 Prot

Lezhë, më 28 / 7 /2023

VENDIM

Nr. 13, Datë 27. 07. 2023

“ PËR MIRATIMIN E PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE, TË INSITUCIONEVE TË VARËSISË, TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE MBËSHTETËSE, TË MASËS SË SHPËRBLIMIT MUJOR TË KËSHILLTARËVE DHE KRYETARËVE TË FSHATRAVE ”

Në mbështetje të nenit 54, ligjit nr.139 /2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar , të ligjit Nr.35 datë 25.05.2023 “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në insitucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, VKM-së nr.328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Ligji nr.89 datë 22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”, të VKB-së Nr.120 datë 02.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesë 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2023”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Komisionit të Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve e të kryetarëve të fshatrave”, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Shpërblimi mujor i këshilltarëve për funksionin që kryen të jetë në masën 10 % të pagës së kryetarit të bashkisë.
3. Shpërblimi mujor i kryetarëve të fshatrave për veprimtarinë që kryejnë të jetë si më poshtë :
 - Në fshatrat deri në 1000 banorë 5.000 lekë.
 - Në fshatrat 1001 – 2000 banorë 5.500 lekë
 - Në fshatrat 2001 – 3000 banorë 6.000 lekë

- Në fshatrat 3001 – 4000 banorë 6.500 lekë
 - Në fshatrat mbi 4000 banorë 7.000 lekë
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 Prill 2023.
 6. Vendimi nr.133,datë 20.12.2022, i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve e të kryetarëve të fshatrave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**



LIDHJA NR.1


Paga mujore në Lekë

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës për çdo kategori	Kategoria	Paga individuale			Paga për Pozicion
			Grupi i diplomes	Paga e Grupit	Shtesë Vjetërsie	
1	Kryetari i Bashkisë	L.1/c				170,000
2	Zëvendëskryetar i Bashkisë	L.1/c				130,000
3	Administrator në Njesite Administrative					
4	Administrator në Njesite Administrative me 5001-20000 banorë	L.9				90,000
5	Administrator në Njesite Administrative nën 5000 banorë	L.9				70,000
6	Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1	14,000	2%	112,000
7	Sekretar i Këshillit Bashkiak	II-b	1	14,000	2%	74,000
8	Drejtor Kabineti	II-b	1	14,000	2%	76,000
9	Këshilltar Juridik	III-a/1	1	14,000	2%	68,000
10	Këshilltar i Kryetarit	III-a/1	1	14,000	2%	55,000
11	Sekretar i Kryetarit	IV-b	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	44,000
12	Drejtor	II-b	1	14,000	2%	75,000
13	Përgjegjës Sektori 1	III-a	1	14,000	2%	61,000
14	Përgjegjës Sektori 2	III-a/1	1	14,000	2%	55,000
15	Specialist 1	III-b	1 ose 2	14,000/12,000	2%	54,000
16	Specialist 2	IV-a	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	49,000
17	Specialist 3	IV-b	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	44,000
18	Kryeinspektor i Policisë Bashkiake	III-a	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	61,000
19	Punonjës i policisë Bashkiake	L.11			1%	47,000
20	Kryeinspektor i IVMT	III-a/1	1	14,000	2%	55,000
21	Inspektor i IVMT	IV-a	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	49,000
22	Përgjegjës institucionesh kulturore	IV-a	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	49,000
23	Përgjegjës i Qendres Kulturore të Femijëve	IV-a	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	49,000
24	Përgjegjës Njësie	IV-a	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	49,000
25	Specialist në Qendrat Kulturore	IV-b	1 ose 2 ose 3	14,000/11,000 / 10,000	2%	44,000
26	Specialist Pyjesh	IV-b	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	40,000
27	Inspektor Pyjesh	IV-b	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	40,000
28	Menaxher Projekti	IV-a	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	49,000
29	Specialist logopedist	IV-b	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	44,000

30	Speciaslist fizioterapist	IV-b	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	44,000
31	Specialist Punonjes Social	IV-b	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	2%	44,000
32	Pergjegjes Klubi Sportit	p.11			1%	47,000
33	Magaznier	p.11			1%	46,000
34	Fotograf	p.11			1%	46,000
35	Kordinator	p.11			1%	42,000
36	Inspektor Terreni per Emergjencat Civile	p.11			1%	42,000
37	Pergjegjes Njesie me Arsim te Mesem	p.11			1%	47,000
38	Teknik (Pergjegjes Grupi)	p.11			1%	45,000
39	Teknik /Teknik Ndertimi	p.11			1%	45,000
40	Topograf	p.11			1%	45,000
41	Agronom	p.11			1%	45,000
42	Punonjes Arke ne Bashki	p.11			1%	42,000
43	Punonjes Protokoll-Arkive-Sekretari	p.11			1%	42,000
44	Fizioterapist	p.11			1%	42,000
45	Psikolog	p.11			1%	42,000
46	Punonjes Kontrolli Higjene	p.11			1%	42,000
47	Elektriçist	p.11			1%	45,000
48	Mekanik	p.11			1%	45,000
49	Marangoz	p.11			1%	45,000
50	Teknik Pyjesh	p.11			1%	40,000
51	Manovrator	p.11			1%	45,000
52	Pergjegjes Çerdheje	p.11			1%	47,000
53	Punonjës Informacioni	p.11			1%	42,000
54	Arketar ne Njesite Administrative	p.11			1%	42,000
55	Hidraulik	p.11			1%	45,000
56	Bojaxhi	p.11			1%	45,000
57	Hidroizolues	p.11			1%	45,000
58	Murator	p.11			1%	45,000
59	Saldator	p.11			1%	45,000
60	Kaldaist	p.11			1%	45,000
61	Shofer administrate	p.11			1%	43,000
62	Shofer ne agjensi/ njesi	p.11			1%	42,000
63	Kujdestare	p.11			1%	45,000
64	Kuzhiniere	p.11			1%	43,000
65	Ndihmes Kuzhiniere	p.11			1%	42,000
66	Punetor Sherbimesh	p.11			1%	40,000
67	Punetor mirembajtje rruges	p.11			1%	40,000
68	Punetor me kontrate per sherbime te ndryshme	p.11			1%	40,000
69	Punonjes me Kontrate	p.11			1%	40,000
70	Pjatalarese	p.11			1%	42,000
71	Roje Pyjesh	p.11			1%	40,000

72	Sanitare	p.11			1%	40,000
73	Roje	p.11			1%	40,000
74	Specialist "Kordinator lokal për turizmin për projektin "Ndërlidhja e turizmit përmes trashigëmisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë"	Paga sipas Kontrates së Grantit 2022/432-185,Ndërlidhja e Turizmit Lezhë - Gjakovë				85,000

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ




KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Mr. 11147/1 prot
dt. 31. 2. 2023

Nr. 588/18 Prot.

Lezhë, më 31. 02. 2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 68 datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 35 datë 25.05.2023 "Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi", VKM-në nr. 328, datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 89 datë 22.12.2022 "Për policinë bashkiake", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 13, datë 27.07.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë, "Për miratimin e pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

